



**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E DRAGASHIT
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ**



**Raporti nga procesi i organizimit të dëgjimeve buxhetore për
Buxhetin e vitit 2026**

Shtator 2025

Hyrje

Planifikimi i buxhetit të Komunës së Dragashit për vitin 2026, bazuar në planifikimet e **Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2026-2028** është **13,254,881 euro**. Në kategorinë e investimeve kapitale për vitin 2026 janë paraparë 4 milionë euro, në kategorinë e pagave dhe mëditjeve **6,941,540 euro**, mallra dhe shërbime **1,513,342 euro**, subvencione dhe transfere **400,000.00 euro**, si dhe shpenzime komunale **400,000.00 euro**. Në kuadër të buxhetit të paraparë për vitin 2026, pjesa më e madhe e planifikimit të të hyrave janë nga Granti Qeveritar (gjithsej Granti nga BKK **12,665,153 euro**), Granti Specifik për Arsimin (**3,766,347 euro**), Granti Specifik për Shëndetësinë (**1,626,763 euro**), si dhe të hyrat vetanake (**589,728 euro**).

Drafti i Buxhetit për vitin 2026 është bërë duke u bazuar kryesisht në Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026-2028, për shkak të vonesës së dërgimit të Qarkores së Dytë Buxhetore nga ministria përkatëse.

Duke u bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Statutin e Komunës së Dragashit 01 Nr.06-103/1 të 11 shtatorit 2008, si dhe Nenit 31 të UA (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, Qarkoren Buxhetore 2026/01 të Ministrisë së Financave, Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim, në koordinim me kryetarin e Komunës së Dragashit, z. Bexhet Xheladini, në bashkëpunim edhe me zyrtarët dhe drejtorët e drejtorive komunale, Grupin Punues për hartimin e projekt-buxhetit të Komunës, si dhe Zyrën për Komunikim me Publikun, kanë bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për organizimin e dëgjimeve buxhetore publike me qytetarë për draftin e Buxhetit komunal për vitin 2026.

Përgatitja e raportit është bërë duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna. Në këtë raport mund të gjeni të dhëna që nga mbajtja e dëgjimit publik dhe mënyra e marrjes së kërkesës nga ana e qytetarëve (formë fizike, elektronike dhe në takimin direkt të mbajtur në lokalitet).

Ecuria e procesit të dëgjimeve buxhetore për Buxhetin e vitit 2026

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore, me datë 25.02.2025, kryetari i Komunës së Dragashit, z. Bexhet Xheladini, ka nënshkruar Vendimin për formimin e Grupit Punues për Organizimin e Dëgjimeve Buxhetore. Grupi Punues për Buxhetin është i përbërë nga dhjetë (10) anëtarë – zyrtarë, drejtorë komunalë nga drejtori të ndryshme:

1. Qamil Kolloni – drejtor për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim (kryesues i Grupit);
2. Arijeta Skeraj – kryesuese e Kuvendit të Komunës;
3. Burim Aliu – ZKF;
4. Fari Kolloni – zyrtar për Informim;
5. Uzair Hamza – shef i Zyrës për Komunitete dhe Kthim;
6. Kaltrina Krasniqi – zyrtare për Buxhet dhe Financa në DKA;
7. Bean Hadziasan – drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit;
8. Arben Skenderi – zyrtar i Financave në Shëndetësi;
9. Lindita Kozmaqi Piraj – zyrtare për Barazi Gjinore; dhe
10. Redzep Ibraimi – drejtor për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike.

Në kuadër të dëgjimeve buxhetore të mbajtura nga data 11.08.2025 deri më datën 04.09.2025 (përfshirë dëgjimin buxhetor të organizuar nga KPF-ja) është diskutuar dhe prezantuar KAB-i i miratuar në Kuvendin e Komunës dhe Lista preliminare e investimeve kapitale. Në këtë proces, Zyra për Informim ka qenë e angazhuar në përpilimin e procesverbaleve të cilat janë publikuar në uebfaqen zyrtare të Komunës së Dragashit.

Në suaza të ecurisë dhe planifikimit sa më të mirë të dëgjimeve buxhetore, Grupi Punues ka hartuar Kalendarin e organizmit të dëgjimeve buxhetore, ku si i tillë është përcjellë edhe me ftesat publike dhe informimi në kohë për ndryshimet që kanë ndodhur gjatë procesit të organizimit të dëgjimeve buxhetore. Ftesat dhe informatat për organizimin e dëgjimeve buxhetore janë publikuar në uebfaqen zyrtare të Komunës (Shqip: <https://dragash.rks-gov.net/degjimet-buxhetore/> ; Boshnjakisht: <https://dragash.rks-gov.net/sr/takimet-publike/>) si dhe në mekanizma tjerë alternativë, të tilla si rrjeti social Facebook (<https://www.facebook.com/profile.php?id=100066575766996>). Krahas planifikimit të dëgjimeve buxhetore me prezencë fizike, Komuna e Dragashit ka synuar që dokumentet e projeksioneve buxhetore të jenë në konsultim edhe përmes formave elektronike, duke u dhënë mundësi qytetarëve të kenë qasje në këto dokumente. Njoftimet për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore publike me qytetarë janë publikuar brenda afateve ligjore në uebfaqen zyrtare të Komunës dhe në rrjetin social Facebook. Në fund të secilit njoftim janë publikuar emailat e zyrtarëve ku qytetarët kanë pasur mundësi t'i dërgojnë kërkesat dhe sugjerimet e tyre. Njoftimet janë publikuar në gjuhët zyrtare.

Përmbledhje tabelare

Përmbajtja	Përshkrimi	Shtesë / Link
Formimi i Grupit Punues	Grupi Punues është formuar më datën 25.02.2025	25.02.2025
Përgatitja e Kalendarit të dëgjimeve buxhetore	Kalendari i dëgjimeve është përgatitur më datën 24.07.2025	 Shqip [https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/07/Kalendari-i-protokolluar-shqip.pdf]  Boshnjakisht [https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/07/Kalendari-i-protokolluar-boshnjakisht.pdf]
Njoftimet për dëgjime buxhetore	Njoftimet për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore janë publikuar më datën 29.07.2025 në uebfaqen zyrtare	 [https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/07/Njoftimi-per-uebfaqe-i-protokolluar.pdf]  [https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/07/Njoftimi-per-uebfaqe-i-protokolluar-1.pdf]  [https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/07/Njoftimi-per-uebfaqe-i-protokolluar-2.pdf]
Procesverbalet e dëgjimeve buxhetore	Procesverbalet e dy dëgjimeve buxhetore të organizuara nga ekzekutivi janë publikuar më datën 18.08.2025, ndërsa procesverbali i dëgjimit buxhetor të organizuar nga KPF	 [https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/08/Procesverbali-i-protokolluar-1.pdf]  [https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/08/Procesverbali-i-protokolluar-2.pdf]

	është publikuar më datën 08.09.2025	 [https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/09/Procesverbali-i-protokolluar.pdf]
Dokumentet e buxhetit	Dokumentet buxhetore publikohen në rubrikat për takimet/dëgjimet publike/buxhetore si dhe në rubrikën e “Financat”	 [https://dragash.rks-gov.net/degjimet-buxhetore/]  [https://dragash.rks-gov.net/financat/]

Grupi Punues, në kuadër të ndarjes së përgjegjësi dhe ndërmarrjes së aktiviteteve për rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e konsultimit publik për projekt-buxhetin e Komunës, kishte planifikuar shfytëzimin e databazës së konsultimeve publike për të targetuar grupe të ndryshme qytetare dhe përfshirjen së tyre në proces të konsultimeve publike. Në këtë kontekst, Grupi Punues përmes Zyrës për Informim, përmes komunikimeve elektronike ka dërguar ftesa të personalizuara për grupe të ndryshme qytetare, përfshirë: OJQ, biznese, përfaqësues të organizatave rinore etj.

Bazuar në Kalendarin e organizimit të dëgjimeve buxhetore, Grupi Punues në koordinim me ekzekutivin e Komunës ka planifikuar të mbajë 3 dëgjime buxhetore, nga data 11 gusht deri më 4 shtator 2025, duke përfshirë dëgjimin buxhetor të organizuar nga KPF-ja. Në të dy dëgjimet buxhetore të organizuara nga ekzekutivi ka marrë pjesë dhe ka prezantuar para qytetarëve kryetari i Komunës, së bashku me drejtorin për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim, ndërsa në dëgjimin e organizuar nga KPF-ja ka prezantuar kryesuesja e Kuvendit, e cila njëherit është edhe kryesuese e KPF-së.

Tabela me të dhënat e përgjithshme

Grupi i interesit / Me kë është mbajtur dëgjimi	Data dhe ora	Lokacioni	Nr. total i pjes.	Gra	Burra	Komunitete joshumicë	Persona me aftësi të kufizuar
Dëgjimi buxhtor me grupet e nënpërfaqësuar (gra, vajza, përfaqësues të komunitetit joshumicë, pensionistë, persona me nevoja të veçanta etj.)	11.08.2025 Ora 11:00	Salla e Asamblesë	30	15	15	3	1
Dëgjimi buxhetor me grupe të interesit (biznese, fermerë, klube sportive, OJQ, klube kulturore etj.)	12.08.2025 Ora 11:00	Salla e Asamblesë	21	6	15	5	0
Dëgjimi buxhetor me qytetarë, i organizuar nga KPF	04.09.2025 Ora 11:00	Salla e Asamblesë	24	3	21	5	0
		Totali:	75	24	51	13	1

Tabela me numrin e kërkesave sipas kategorive buxhetore

Grupi i interesit / Me kë është mbajtur dëgjimi	Nr. total i kërkesave ¹	Investime Kapitale	Subvencione	Mallra dhe Shërbime	Kërkesa për Informacion /pyetje
Dëgjimi buxhtor me grupet e nënpërfaqësuar (gra, vajza, përfaqësues të komunitetit joshumicë, pensionistë, persona me nevoja të veçanta etj.)	9	5	1	2	1
Dëgjimi buxhetor me grupe të interesit (biznese, fermerë, klube sportive, OJQ, klube kulturore etj.)	5	1	0	0	4
Dëgjimi buxhetor me qytetarë, i organizuar nga KPF	6	3	0	1	2
Totali:	20	9	1	3	7

¹ **Shënim:** Numri i kërkesave të parashtruara përfshin si **kërkesa konkrete** (për projekte, subvencione apo mallra/shërbime), ashtu edhe **pyetje apo kërkesa për informacion**, të cilat janë ndërlidhur me progresin e ndonjë investimi ekzistues, procedura për përfitime komunale, etj.

Metodologjia dhe kriteret për klasifikimin e statusit të kërkesave

Grupi Punues për Organizimin e Dëgjimeve Buxhetore, gjatë analizimit dhe shqyrtimit të kërkesa të qytetarëve merr për bazë një sërë kriteresh për kategorizimin e këtyre kërkesave si kërkesa të pranuar, të adresuara, pjesërisht të pranuar apo të refuzuara. Si kriter kryesor merren mundësitë buxhetore dhe shqyrtimi i mjeteve të lira që janë në dispozicion; pastaj shqyrtohet edhe aspekti social dhe gjinor, përmes të cilëve Grupi Punues synon që t'u japë përparësi kërkesave të grave, personave me nevojave të veçanta etj. Një kriter tjetër që merret parasysh është edhe kompetenca e Komunës dhe, në rastet kur kemi të bëjmë me kërkesa që i tejkalojnë kompetencat e qeverisë lokale, atëherë kërkesat apo propozimet e kësaj natyre adresohen në institucionet përkatëse apo refuzohen. Gjithashtu, Grupi Punues merr parasysh dhe priorizon kërkesat dhe propozimet e kryetarëve të këshillave të fshatrave, përfaqësuesve të bizneseve, fermerëve, grupeve të ndryshme kulturore dhe sportive, për arsye se konsiderohet që këto grupe të ndryshme të interesit përfaqësojnë edhe interesat e një numri të madh të qytetarëve të cilët për çfarëdo arsye nuk kanë mundur të jenë pjesë e dëgjimeve buxhetore, qoftë në mënyrë fizike, apo përmes konsultimeve online.

Pranim/Aprovim: Nënkupton që kërkesa konkrete e qytetarit konsiderohet se është e nevojshme për t'u realizuar dhe si e tillë do të jetë pjesë e buxhetit për vitin 2026. Pra kërkesat e tilla, si për projekte kapitale, subvencione apo mallra & shërbime janë në buxhetin që i shkon kuvendit/asamblesë për miratim me 1 shtator.

Adresim: nënkupton që kërkesa e qytetarit adresohet te subjekti, palët, institucioni relevant. Kjo mund të jetë relevante, për shembull, kur kërkesat e qytetarëve nuk janë në kompetencën komunale dhe janë përgjegjësi/kompetencë e një institucioni tjetër (si p.sh. KEK-ut, apo Ujësjiellësit etj.) dhe kur klasifikohet si e “Adresuar” nënkupton që Komuna do të adresojë apo ka adresuar kërkesën tek institucioni relevant. Adresuar po ashtu mund të nënkuptojë që një kërkesë e qytetarit vetëm se gjen adresim në projektet ekzistuese komunale (të cilat mund të kenë filluar në vitet paraprake apo janë të planifikuara për vitet pasuese për të cilin po mbahet konsultimi.

Pjesërisht e pranuar/aprovuar: Këtu mund të klasifikohen kërkesat e qytetarëve të cilat mund të përfshijnë disa lloj intervenimesh (p.sh. në shtrimin e një rruge mund të kërkohet që përveç asfaltimit të rrugës, të punohet edhe në ndriçimin publik të asaj rruge). Në këto raste, nëse komuna mund të ketë këtë mundësi buxhetore apo thjesht të prioritzojë vetëm një segment të kësaj kërkesë (p.sh. shtrimin e rrugës) atëherë arsyetohet që për këto arsye, kërkesa aprovohet për shtrimin e rrugës, mirëpo për vitin 2026 nuk do të ketë mundësi intervenimi në ndriçim publik. Si e tillë, kërkesa mbetet pjesërisht e pranuar/aprovuar.

E refuzuar: Nënkupton kërkesat e qytetarëve të cilat nuk përfshihen në buxhetin e komunës për vitin 2026. Kjo mund të jetë për shumë arsye, e që mund të përfshijnë: mungesën e mjeteve financiare, faktin që kërkesa nuk bën pjesë në prioritetet komunale, faktin që kërkesa është më shumë e natyrës individuale se sa me ndikim në komunitet, faktin që për realizimin e kërkesës/investimit do të duhet fillimisht të mënjanohen probleme të ndryshme si shpronësimet, apo fakti që menaxhimi i pronës nuk është në kompetencë komunale etj.

Tabela e detajuar me informatat për kërkesat e dhëna, arsyetimet për kërkesat e pranuar dhe të refuzuara

INVESTIME KAPITALE			
Kërkesat, sugjerimet, idetë e parashtruara në konsultim	Emri i personit/organizatës	Statusi i kërkesës	Përgjigja dhe arsyeshmëria e komunës/grupit punues
Rregullimi i zyrës ekzistuese ose ndërrimi i zyrës për personat me aftësi të kufizuara	Shaqir Skeraj, përfaqësues i organizatës për personat me aftësi të kufizuar	Pranuar	Komuna ka nënshkruar marrëveshjen për ndërtimin e Qendrës Multifunkionale në Dragash dhe në kuadër të këtij objekti do të ndahet edhe një zyrë e re për personat me aftësi të kufizuar.
Ndërtimi i një qendre të tubimit për gratë në zonën e Opojës	Xhylferi Bahtijari, asambleiste	Pranuar	Komuna në bashkëpunim me OJQ dhe donatorë ka hapur një qendër të tillë në qytezën e Dragashit. Do të shikohen mundësitë që një tjetër të hapet edhe në zonën e Opojës.
Ndërtimi i një këndi të lojërave për fëmijë në mahallën “te Xhamia” në fshatin Zaplluxhe	Xhylferi Bahtijari, asambleiste	Pranuar	Kjo kërkesë është futur në Listën e Shpenzimeve Kapitale (Projekti: “Rehabilitimi i rrugës Preslllop dhe Kroi i Ftohët, ndërrimi i gypit të ujësllësit të lagjes së Hysenajve, dhe ndërtimi i këndit të lojërave në qendër – mahalla Te Xhamia, në fshatin Zaplluxhe”) dhe për vitin 2026 janë paraparë 13 mijë euro.
Funksionalizimi i rrugës së vjetër Bellobrad-Mejdan	Beqir Beqaj, përfaqësues i fshatit Bellobrad	Adresuar	Kjo kërkesë fillimisht do të adresohet në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
Ndërtimi i trotuareve	Beqir Beqaj, përfaqësues i fshatit Bellobrad	Pranuar	Komuna do ta realizojë projektin “Ndërtimi i trotuarit Brodosan-Zaplluxhe dhe Brrut-Bellobrad” me mjetet e financuara nga Granti i Performancës.

Në fshatin Pllajnik me mjetet e planifikuara të ndërtohen më shumë mure mbrojtëse në vend të kubëzimit	Abaz Qengaj, përfaqësues i fshatit Pllajnik (OJQ “Kroi i Macës”)	Pranuar	Komuna do të shpenzojë 90% të mjeteve të parapara për ndërtimin e mureve mbrojtëse. Projekti është hartuar dhe është në fazën e tenderimit.
Kyçja e lagjes së Dragashit të Epërm (Pllajniku i Vogël) në rrjetin e ri të ujësjellësit)	Bekim Qusaj, përfaqësues i Dragashit nga komuniteti shqiptar	Pranuar	Do të shqyrtohen mundësitë që kjo pjesë të përfshihet në projektin e përgjithshëm të Ujësjellësit për 15 fshatra dhe qytezën e Dragashit.
Rregullimi dhe riparimi i kanalizimit të lagjja e re në Dragash (Rruga e Restelicës)	Bekim Qusaj, përfaqësues i Dragashit nga komuniteti shqiptar	Pranuar	Kjo kërkesë është futur në Listën e Shpenzimeve Kapitale (Projekti: “Rehabilitimi i infrastrukturës rrugore dhe ndërtimi i kanalizimit të Lagjja e Re në qytezën e Dragashit) dhe për vitin 2026 janë paraparë 30 mijë euro.
Zgjerimi dhe shenjëzimi i rrugës nga Lapidari deri te Ura e Haxhi Musës (Rrenc)	Artan Loshaj, asambleist dhe anëtar i KPF-së	Refuzuar	Për fshatin Rrenc janë paraparë disa investime të tjera për vitin 2026. Për shkak të mjeteve të pamjaftueshme buxhetore, kjo kërkesë do të shqyrtohet vitin e ardhshëm.
SUBVENCIONE			
Kërkesat, sugjerimet, idetë e parashtruara në konsultim	Emri i personit/organizatës	Statusi i kërkesës	Përgjigja dhe arsyeshmëria e komunës/grupit punues
Subvencionimi i grave të prekura me kancer	Lindita Kozmqai Piraj, Zyrtare për Barazi Gjinore	Pranuar	Komuna do zbatojë të njëjtën praktikë të subvencionimit sikur këtë vit, përmes subvencioneve nga Zyra e Kryetarit.
MALLRA & SHËRBIME			
Kërkesat, sugjerimet, idetë e parashtruara në konsultim	Emri i personit/organizatës	Statusi i kërkesës	Përgjigja dhe arsyeshmëria e komunës/grupit punues
Sigurimi i transportit ndërrurban për	Lindita Kozmqai Piraj, Zyrtare për Barazi Gjinore	Adresuar	Komuna e ka adresuar disa herë këtë kërkesë në ministrinë përkatëse të Transportit dhe Telekomunikacionit. Nuk ka asnjë

gratë e zonave të Opojës dhe Gorës			pengesë ligjore për realizimin e kësaj kërkeje, vetëm pritet miratimi nga ana e autoriteteve qendrore.
Sigurimi i PAPA TESTIT pa pagesë për gratë	Lindita Kozmqai Piraj, Zyrtare për Barazi Gjinore	Pranuar	Komuna (përmes Drejtorisë së Shëndetësisë dhe QKMF-së) ka filluar realizimin e këtij shërbimi gjatë vitit 2025 dhe do të vazhdojë me të njëjtin shërbim edhe vitet e ardhshme.
Kyçja e zyrës së HANDIKOS-it dhe QPS-së në rrjetin e ujësjellësit, si dhe ndërrimi i gypit të ujësjellësit në lagjen kah rruga e Kukajanit	Bekim Qusaj, përfaqësues i Dragashit nga komuniteti shqiptar	Pranuar	Këto intervenime mund të bëhen duke i mbuluar shpenzimet përmes kategorisë Mallra dhe Shërbime.
PYETJE/KËRKESË PËR INFORMACION/SUGJERIME			
Kërkesat, sugjerimet, idetë e parashtruara në konsultim	Emri i personit/organizatës	Statusi i kërkesës	Përgjigja dhe arsyeshmëria e komunës/grupit punues
Deri në cilën fazë ka shkuar projekti „Hapja e rrugës Zadrit dhe ndërtimi i infrastrukturës tjetër për nevojat e fshatit Rapçë“	Munir Jonuzi, përfaqësues i fshatit Rapçë	Adresuar	Komuna ende nuk ka filluar ndonjë procedurë lidhur me një projekt të tillë. Për hapat e mëtejshëm do të konsultohet Zyra e Prokurimit.
Të bëhen disa ndryshime në organizimin e manifestimit “Sofra e Ymer Prizrenit”. Të ndërrohet emri në “Ditët e Ymer Prizrenit” dhe manifestimi të zgjat dy ose tri ditë	Abaz Qengaj, OJQ “Kroi i Macës”	Pranuar	Komuna dhe drejtoria përkatëse për Kulturë do ta shqyrtojë këtë propozim gjatë shpalljes së thirrjes publike për organizimin e këtij manifestimi.
Ruajtja dhe konservimi i shtëpisë sime të	Abaz Qengaj, OJQ “Kroi i Macës”	Adresuar	Monumentet kulturore dhe historike janë kompetencë e qeverisë qendrore. Kërkesa për konservimin e shtëpisë fillimisht të

vjetër si bujtinë për qëllime turistike			dërgohet në DKRS dhe pastaj e njëjta do të adresohet në Zyrën Rajonale për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore në Prizren.
A ka mundësi që për një periudhë të shkurtë të ndahet një pjesë e buxhetit për KF "OPOJA"	Halil Isufi, përfaqësues i KF "OPOJA"	Adresuar	Komuna ka ndarë për çdo vit mjete për Klubin Futbollistik "OPOJA". Vitin e ardhshëm do të merret parasysh edhe kjo kërkesë dhe do të shihen mundësitë buxhetore për ndarjen e mjeteve, si dhe do të shihen mundësitë e bashkëpunimit me donatorë të ndryshëm për mbështetjen financiare të Klubit.
Si do të shkojë këtë vit procedura e organizimit të Panairit me Produkte Vendore Lokale dhe a do të ketë ndonjë ndryshim? Propozoj që të ulemi bashkë dhe të diskutojmë që të bëjmë diçka shtesë për këtë ngjarje	Beqir Beqaj, përfaqësues i Shoqatës së Afaristëve "Sharri"	Adresuar	Komuna ka shpallur Thirrjen publike për organizimin e këtij Panairi dhe, ndryshe nga vitet tjera që janë paraparë nga 12 mijë euro, këtë vit janë paraparë të ndahen 13 mijë euro për organizimin e tij. Komuna është e gatshme që ta diskutojë me grupet e interesit çfarëdo propozimi apo ideje lidhur me organizimin e kësaj ngjarjeje ekonomike e cila po ndikon çdo vit në promovimin e bizneseve lokale.
Në QMF-në e fshatit Bresanë të bëhet shërbimi i kujdestarisë 24 orë pa ndërprerje	Suel Ahmeti, banor i fshatit Bresanë	Adresuar	Komuna do të shqyrtojë mundësitë ligjore, nëse është e mundshme të kryhet ky shërbim për qytetarët.

Hapja, trasimi dhe rehabilitimi i rrugës që lidh fshatrat Buqe, Pllavë dhe Rapçë me bjeshkën (Koritnikun)	Brendi Berisha, Përfaqësues i fshatit Buqe Munir Jonuzi, Përfaqësues i fshatit Rapçë	Adresuar	Komuna është duke realizuar një sërë projektsh të kësaj natyre në bashkëpunim me LMT-në e KFOR-it Turk në Dragash. Përmes kërkesës zyrtare të adresuar për KFOR-in Turk, do të angazhohemi që gjatë vitit të ardhshëm të bëhet i mundur edhe realizimi i këtij projekti.
---	--	----------	--

Tabela me numrin e kërkesave sipas statusit të kërkesës

Grupi i interesit / Me kë është mbajtur dëgjimi	Nr. total i kërkesave	Numri i kërkesave të pranuar	Numri i kërkesave të adresuara	Numri i kërkesave pjesërisht të pranuar	Numri i kërkesave të refuzuara
Dëgjimi buxhtor me grupet e nënpërfaqësuar (gra, vajza, përfaqësues të komunitetit joshumicë, pensionistë, persona me nevoja të veçanta etj.)	9	6	3	0	0
Dëgjimi buxhetor me grupe të interesit (biznese, fermerë, klube sportive, OJQ, klube kulturore etj.)	5	2	3	0	0
Dëgjimi buxhetor me qytetarë, i organizuar nga KPF	6	3	2	0	1
Totali:	20	11	8	0	1

**Përgatiti:
Grupi Punues**